



BASHKIA  
TIRANË

**KESHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 90, datë 26. 07. 2017

**PËR**

**“MIRATIMIN E ANËTARËSIMIT TË BASHKISË SË TIRANËS NË SHOQATEN  
NDËRKOMBËTARE UITP (SHOQATA NDËRKOMBËTARE E TRANSPORTIT PUBLIK)”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b), pika 1/1.5, pika 1/1.6, nenit 40, pika 4, nenit 54, shkronja (d), nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 4 të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar); ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgimninë kulturore” (i ndryshuar); nenit 10 të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”; vendimit nr. 84 datë 29.12.2016 të Këshillit Ministrave “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2017” (i ndryshuar) si dhe nisur nga dëshira për zhvillimin dhe promovimin e transportit në qytetin e Tiranës, duke e ngritur në nivele ndërkombëtare, e aftë për t’u krahasuar me transportin në vendet e zhvilluara, duke synuar arritjen e niveleve të larta të shërbimit të transportit publik, nëpërmjet përfitimit të eksperiencave të vendeve anëtare të UITP (*Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Publik*), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë antarësimin e Bashkisë Tiranë, si anëtar në Shoqatën Ndërkombëtare UITP (*Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Publik*).
2. Miratimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqatës Ndërkombëtare UITP (*Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Publik*) sipas aneksit Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij, të përfaqësojnë Bashkinë e Tiranës në organet përfaqësuese të shoqatës, si dhe të kryejnë çdo veprim të nevojshëm që vjen si rrjedhojë e anëtarësimit në këtë shoqatë.
4. Efektet financiare për pagesën e kuotës vjetore të anëtarësisë, përballohen nga buxheti i miratuar çdo vit për Bashkinë Tiranë dhe kryhet sipas parashikimeve të përcaktuara në statutin dhe aktet e shoqatës, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

5. Kuota e anëtarësisë për vitin 2017, në shumën 2500 (dymijëepesëqind) euro, do të përballohet nga fondi i Aparatit të Bashkisë në programin e Administratës Vendore për kuota anëtarësie.
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike si dhe Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit European për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**KRYETARI**

**ALDRIN DALIPI**